



BiEPAG

Virusi i dyshimtë: Konspiracionet dhe Covid-19 në Ballkan

Ashtu si pjesa tjetër e botës, edhe Ballkani Perëndimor është ndikuar shumë nga teoritë konspirative, ku për shkak të pandemisë lindin dyshime për politikat qeveritare dhe besimi tek institucionet. Shkalla dhe intensiteti i këtyre teorive dhe implikimet e tyre janë tejet të forta. Teoritë konspirative lidhur me Covid-19 mbështeten nga rreth 1/4 deri në 1/3 e popullsisë, ndërkohë që më shumë se 75% e qytetarëve të anketuar në Ballkanin Perëndimor besojnë në një ose disa nga gjashtë teoritë konspirative që lidhen me Covid-19. As arsimi, as mosha dhe as gjinia nuk kanë ndikim të madh të këto shifra. Përkundrazi, ekziston një tendencë gjeopolitike, ku besimi te teoritë konspirative bashkëshoqëron shpesh ndjenjat për ShBA-të dhe Kinën. Pakicat, që janë më të cenueshëm dhe që kanë më pak besim te shteti, janë më të prekshëm ndaj konspiracioneve.

Ka një lidhje të drejtpërdrejtë mes mbështetjes për teoritë konspirative dhe skepticizmit ndaj vaksinimit. Shumica në të gjithë rajonin nuk kanë ndërmend të marrin vaksinën, raport që është mjaft më i ulët se në vende të tjera në Evropë, ku shumica mbështetin marrjen e vaksinës. Teoritë konspirative përbëjnë rrezik për shëndetin publik në Ballkanin Perëndimor dhe dobësojnë besimin tek institucionet dhe te shteti duke nxitur një botëkuptim populist që minon zhvillimin demokratik.

Florian Bieber, Tena Prelec, Dejan Jović dhe Zoran Nechev¹

Teoritë e konspiracionit, qofshin ato të mëdha apo të vogla, duket se e kanë rritur fuqinë e tyre në nivel global në vitin 2020. Nga *QAnon* me origjinë nga ShBA e deri tek *querdenker* në Gjermani, që mohojnë pandeminë dhe i krahasojnë kufizimet e qeverisë me Gjermaninë Naziste, në mediat sociale dhe tek mijëra vetë që dalin në rrugë në të gjithë botën duket se po galvanizojnë pretendime të çuditshme. Teoritë e konspiracionit nuk janë të reja, por përhapja e madhe e tyre dhe gatishmëria e mijëra njerëzve për të dalë në rrugë është e re dhe u ka dhënë atyre vëmendje edhe më të madhe.

Në përgjithësi, konspiracionet ushqejnë politikat radikale dhe anti-demokratike. Teoritë konspirative bëjnë që të dalin individë, të cilët refuzojnë shkencën, si vaksinat dhe mjekimet e këshillat e tjera konvencionale. Këto teori lulëzojnë në një mjedis të krijuar nga dukuri që janë të vështira për t'u shpjeguar, nga pasiguria dhe besimi i ulët te shoqëria dhe institucionet. Teksa duke përdorur arsyen mund ta imagjinojmë një virus, ai është i padukshëm dhe na kërcënon papritmas në mjedisin tonë normal, duke na e bërë të vështirë të kuptojmë dhe pranojmë kalimin nga rutina normale drejt e tek mbylljet totale dhe distancimi social. Nëse kjo sfidë përkon me një ndjenjë të përgjithshme pasigurie, qoftë kjo e lidhur me vendin e punës, pozitën sociale dhe rrjetet e tjera të mbështetjes, mund të lulëzojnë komplotet. Së fundmi, nëse kjo është pjesë e një ambienti ku besimi është në nivel të ulët, ku nuk besohen këshillat që jepen nga qeveria dhe shpjegimet e shkencëtarëve, këto teori lulëzojnë.

Në Ballkanin Perëndimor, teoritë e konspiracionit bien në tokë pjellore. Institucionet janë të dobëta dhe shpesh publiku nuk ka besim në to. Po ashtu, në këtë rajon ka histori të hershme që lidhen me teori konspirative, të cilat lulëzuan veçanërisht gjatë viteve 1990. Ndonëse konspiracionet me Covid-19 janë në sintoni me tendencat globale, ato janë më të forta në Ballkanin Perëndimor, siç sugjeron sondazhi i realizuar nga BIEPAG/IPSOS i Ballkanit Perëndimor, dhe potencialisht më shkatërrues.

Në këtë dokument, bazuar në të dhënat e sondazhit të BIEPAG/IPSOS, do të shqyrtojmë kontekstin e teorive konspirative në Ballkanin Perëndimor, para se të diskutojmë format e nivelit të lartë të mbështetjes për konspiracionet e Covid-19 në rajon në kontekstin evropian, pasuar nga shqyrtimi i tendencat rajonale që lidhen me gjeopolitikën dhe pakicat. Së fundi, në këtë dokument do të shqyrtohen implikimet për sa i përket vaksinimit dhe zhvillimeve të mëtejshme politike. Siç do të argumentohet në këtë dokument, përhapja e besimit në konspiracionet Covid-19 përbën rrezik serioz për shëndetin publik dhe demokracinë në rajon.

Konteksti

Teoritë konspirative që lindën në Ballkan, ashtu si edhe në pjesë të tjera të botës, lidhen me konceptin e Armikut, të Tjetrit që punon pandërprerë kundër Nesh, me objektivin përfundimtar të shkatërrimit të kombit tonë dhe identitetit të tij. Në këtë mënyrë, Armiku akuzohet se punon në bashkëpunim me "tradhtarët e brendshëm".

Dominimi i të Tjerëve ndaj Nesh do të ishte i pamundur pa një sponsor të fuqishëm të huaj, i cili bashkoi forcat me "bashkëpunëtorët e brendshëm". Shembull i famshëm është shpjegimi konspirativ i të ashtuquajturit "Vatikan-Komintern" i "komplotit" të Partisë Komuniste Jugosllave kundër serbëve dhe Serbisë. Nga ana tjetër, edhe konspiracioni për serbë të plotfuqishëm, që nënshtruan kroatët përmes kontrollit të plotë të aparatit shtetëror, ishte po aq "bindës". Por të dy këto teori u përhapën gjerësisht në segmente të ndryshme të popullsisë. Për shembull, në vitin 2011, 93 përqind e qytetarëve kroatë besonin në të paktën një teori konspirative, ndërkohë që si mesatare ata besonin në pesë teori të tilla.²

Me shpërbërjen e Jugosllavisë dhe luftën që pasoi, shpjegimet konspirative morën një dimension të ri. Çdokush fajësonte dikë tjetër për atë që i kishte ndodhur dhe të gjithë e drejtonin gishtin te një forcë e jashtme që mbështeste armiqtë e tyre. Në listën e 'armiqve të brendshëm' të shteteve të reja të pas-Jugosllavisë bënin pjesë pakicat etnike, forcat liberale dhe ato që ishin kundra luftës, të cilët gjoja komplotonin me Fondacionin Soros (Fondacioni Shoqëria e Hapur), me forcat e globalizimit dhe me Tribunalin e Hagës. E kaluara dhe e tashmja komplekse, e vështirë për t'u kuptuar, u bë kështu më e lehtë për t'u interpretuar dhe pranuar për shumë njerëz.

Teoritë konspirative vazhdojnë të përhapen gjerësisht nga media dhe politikanët kryesorë në Ballkanin Perëndimor. Gazetat serbe *Informer* dhe *Srpski Telegraf* e kanë përmendur kërcënimin e luftës dhe të konfliktit të armatosur jo më pak se 265 herë gjatë një periudhe një vjeçare 2016-7. Politikanët kryesorë nga qeveria dhe opozita në Serbi, Mali i Zi dhe gjetkë shpesh evokojnë kërcënimin e një elite "globaliste" dhe në këtë aspekt Xhorxh Soros është rregullisht një "dele e zezë". Me fillimin e pandemisë, teoritë konspirative si dhe premtimi se popullsia do të mbrohej nga gjenet e tyre, hormonet, ozoni apo nga thjesht rakia kanë zënë një hapësirë të madhe në shtyp, TV dhe te personazhet publike. Pra, a kanë dhënë fryte pretendime dhe konspiracione të tilla?³

1 Duam të falënderojmë edhe anëtarët e tjerë të BIEPAG për komentet e tyre.

2 Nebojša Blanuša: *Teorije zavjera i hrvatska politička zbilja 1980. – 2007*. Plejada, Zagreb, 2011, p. 316.

3 Florian Bieber, "Conspiratorial Corona: Hoaxes and Conspiracy Theories in the Balkans," *Balkan Insight*, 7.7.2020, <https://balkaninsight.com/2020/07/07/conspiratorial-corona-hoaxes-and-conspiracy-theories-in-the-balkans/>



Si qëndrojnë teoritë konspirative në Ballkan?

Në një botë që gëlon nga dyshimet për rrezikun vdekjeprurës të koronavirusit dhe origjinën e tij, përhapja e teorisë konspirative ka marrë një vëmendje të paprecedentë. Me përhapjen e Covid-19 u shfaqën teoritë e shumta konspirative, të cilat u përhapën në të gjithë botën ashtu si edhe vetë virusi. Jo të gjitha teoritë konspirative janë të barabarta. Disa përmbajnë elemente të së vërtetës ose mund të jenë të vërteta, por që mbeten deri në ditët e sotme të paprovuara. Kështu, besimi në to nxjerr në pah një nivel më të ulët të të menduarit në mënyrë konspirative sesa në teoritë që janë më të çuditshme. Ndër teoritë konspirative të vëzhguara në sondazhin në rajonin e Ballkanit, më pak e papranueshmja është teoria që virusi doli nga një laborator në Wuhan, d.m.th. se ai kishte ekzistuar shumë më herët nga sa dihej publikisht dhe origjina e tij ishte fshehur nga Kina.

Aq më pak e besueshme është teoria që pretendon se koronavirusin e ka krijuar qeveria kineze në një laborator. Kështu, virusi nuk është me origjinë natyrore, por i krijuar nga vetë njeriu. Nuk ka asnjë provë për këtë pretendim, por ka shumë prova që sugjerojnë se virusi evoluoi natyrshëm. Katër teoritë e tjera më të përhapura të konspiracionit janë shumë më të çuditshme, përfshirë pretendimet se virusi u përhap nga industria farmaceutike; se qeveria amerikane e krijoi virusin si armë biologjike; se virusi është i lidhur me teknologjinë 5G dhe, ndoshta më e pabesueshmja, se është përhapur për t'i bërë të mundur Bill Gates t'u instalojë njerëzve një çip nëpërmjet vaksinës. Ndonëse, me përjashtim të dy të parëve, shumica e teorisë përgënjeshtrojnë njëra tjetrën, besimi në to nuk ka të njëjtin fat.

Në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara, sondazhet e kryera gjatë periudhës së fillimit të pandemisë deri në nëntor 2020 sugjerojnë se teoritë konspirative kanë pasur njohje dhe përhapje të gjerë. Gjithsesi, përhapja e tyre kufizohet te një pakicë e caktuar. Si tendencë e përgjithshme, rreth një e katërta e popullsisë duket se

i mbështesin teoritë e konspiracionit, ku varion mes atyre teorisë që janë më pak intensive, të tilla si ideja se virusi u krijua në një laborator, dhe konspiracione më ekstreme si lidhja me rrjetet 5G. Për shembull, në Itali, vendi që u godit më rëndë nga pandemia në valën e parë, përqindja e atyre që besojnë në teori të ndryshme konspirative arriti në total në një të katërtën e të anketuarve në nëntor 2020. Të dhënat për Poloninë na japin shifra të njëjta, ku 23% besojnë se virusi u përhap qëllimisht dhe 23.5% janë të mendimit se virusi është pjesë e një komploti ndërkombëtar. Besimi se virusi e ka origjinën nga një laborator mbështetet nga 44.8% dhe vetëm 5.6% besojnë se rrjeti 5G ka lidhje me përhapjen e Covid-19.⁵ Edhe Gjermania ka shifra të ngjashme, shifra që nuk kanë ndryshuar që nga maji 2020, ku 16-19% besojnë se Covid-19 është thjesht një mashtrim dhe 14-18% besojnë se virusi është krijuar nga njeriu. Duke pasur një mbivendosje prej 8.5% (në nëntor 2020), përqindja e atyre që i besojnë të dy teorisë shkon në 22.5%. Edhe rezultatet e një sondazhi të kryer po në Gjermani që nga muaji mars 2020⁴ dalin me shifra të ngjashme të popullsisë që mbështesin teoritë konspirative: 8% besojnë se janë disa organizata sekrete që ndikojnë në vendimet që merren për pandeminë dhe 24% besojnë se media dhe politika po fshehin informacionin në lidhje me pandeminë.⁶ Edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku kemi një përhapje tejet të madhe të teorisë konspirative në publik, madje edhe nga vetë Presidenti Trump, kanë përqindje të ngjashme. Në një sondazh të kryer në korrik 2020, një e katërta e të anketuarve besojnë se pandemia është e planifikuar nga "njerëz të fuqishëm".⁷ Ashtu si me treguesin tjetër të lidhur me mbështetjen e konspiracioneve, 22% e amerikanëve besojnë se Covid-19 është armë biologjike kineze, ndërkohë që 49% e hedhin poshtë menjëherë këtë teori. Më e përhapur ka qenë ajo pjesë e publikut që refuzon maskat dhe kufizimet e tjera dhe që nuk e konsideron virusin më të rrezikshëm se një grip i zakonshëm. Edhe pse ka një polarizim tejet të madh për këtë çështje, që kontribuon në përhapjen e saj, përqindja e mbështetjes për këtë minimizim të rrezikut të pandemisë kap një të tretën e popullsisë.⁸ Përhapja e teorisë konspirative është e madhe në nivel botëror, por shifrat në Ballkanin Perëndimor janë

4 Duke u rritur nga 19% që ishte në shtator <https://www.swg.it/observatory>

5 Biostat, Mity o koronawirusie. Polacy o skuteczności ochrony przed SARS-CoV-2, 23.9.2020, https://www.biostat.com.pl/news/mity_o_koronawirusie_polacy_o_skuteczności_ochrony_przed_sars_cov_2.php

6 "Institut für interdisziplinäre Konflikt- und Gewaltforschung (IKG), Erste Ergebnisse einer Online-Umfrage zur gesellschaftlichen Wahrnehmung des Umgangs mit der Corona-Pandemie in Deutschland", prill 2020.


7 Katherine Schaeffer, "A look at the Americans who believe there is some truth to the conspiracy theory that COVID-19 was planned," Pew Research Center, 24.7.2020,

8 <https://www.pewresearch.org/fact-tank/2020/07/24/a-look-at-the-americans-who-believe-there-is-some-truth-to-the-conspiracy-theory-that-covid-19-was-planned/> Në total, 19% besojnë (më së shumti ose plotësisht) se Hidroksiklorokina është trajtim i sigurt. Daniel A. Cox, John Halpin, "Conspiracy theories, misinformation, COVID-19, and the 2020 election, Findings from the September 2020 American Perspectives Survey," (Teoritë konspirative, disinformimi, Covid-19 dhe zgjedhjet 2020, Gjetjet nga Sondazhi i Këndvështrimeve Amerikane shtator 2020) Qendra e Sondazheve për Jetën Amerikane, 13.10.2020, <https://www.americansurveycenter.org/research/conspiracy-theories-misinformation-covid-19-and-the-2020-election/org/research/conspiracy-theories-misinformation-covid-19-and-the-2020-election/>




tejet të larta. Nga gjashtë teoritë më të zakonshme konspirative të zbuluara në nivel botëror, tre kanë më shumë besimtarë sesa jo-besimtarë; pra, që qeveria kineze e krijoi virusin në një laborator, që industria farmaceutike është e përfshirë në përhapjen e tij dhe se virusi doli nga një laborator në Wuhan (shih grafikun 1). Tre teoritë konspirative më të çuditshme, që janë lidhja me teknologjinë 5G, përfshirja e ushtrisë amerikane në krijimin e virusit si armë biologjike dhe përhapja e Covid-19 nga Bill Gates për të ulur numrin e popullsisë në botë, kanë më shumë jobesimtarë sesa besimtarë, por që, gjithsesi, në rajon 27.7 deri 34.9% e popullsisë pretendojnë se këto teori përmbajnë disa, ose shumë të vërteta. Kjo do të thotë që nga një e katërta deri te gjysma e popullsisë janë dakord me të paktën një prej teorive konspirative.

Vendi me numrin më të lartë të mbështetësve të teorive konspirative në Ballkanin Perëndimor është Shqipëria. Këtu, të gjitha teoritë, pa marrë parasysh sa kontradiktore janë, kanë një numër më të madh mbështetësish në krahasim me njerëzit që nuk u besojnë atyre. Më të përhapurat janë teoritë që i atribuojnë përgjegjësinë Kinës, por edhe lidhja me Bill Gates konsiderohet të ketë shumë ose një farë të vërtete për këtë teori sipas mendimit të më shumë se 43% të popullsisë. Në përgjithësi, në rajon gati 80% besojnë shumë, ose disi, në një prej teorive konspirative që lidhen me Covid-19. Ndërkohë që numri i atyre që i besojnë më shumë një prej teorive varion nga 41.5% në Serbi në 59.4% në Shqipëri, numri total i atyre që japin disi dhe shumë besueshmëri një apo disa teorive është i qëndrueshëm në të gjithë rajonin.



Grafiku 1: Mbështetje për teoritë konspirative të Covid-19 në Ballkanin Perëndimor (sipas 6 teorive konspirative më kryesore)




Grafiku 2: Mbështetja kumulative për teoritë konspirative Covid-19 në Ballkanin Perëndimor

Teoritë konspirative nuk zhduken apo zgjidhen duke rritur nivelin e njohurive. As arsimit dhe as mosha e re nuk janë mbrojtje e mirëfilltë nga besimi të konspiracionet. Ndonëse studimet e teorive konspirative në përgjithësi sugjerojnë një lidhje të fortë me nivelin e ulët arsimor,⁹ nuk ka një tendencë të tillë në Ballkanin Perëndimor. Disa teori janë më shumë të përhapura tek të rinjtë dhe të mirëarsimuarit, disa të tjera të mosha e mesme dhe me arsim të mesëm, ndërkohë që disa teori të tjera janë më të përhapura të mosha e thyer dhe më pak të arsimuar. Ky ndryshim nuk shpjegohet as me ndarjen sipas gjinive apo vendbanimit në zonë rurale apo urbane. Për shembull, në Kosovë, 47% e popullsisë me arsim të mesëm besojnë se industria farmaceutike po përhap virusin, krahasuar me vetëm 22.2% të atyre me arsim fillor. Kjo do të thotë se teoritë konspirative janë rrënjësuar thellë në të gjitha shtresat e shoqërisë. Grupe të ndryshme kanë teorinë e tyre të parapëlqyer konspirative, por mesatarisht ka fare pak ndryshime mes tyre. Si për habi, ata që janë dakord më shumë me teoritë konspirative thonë se ndeshen më rregullisht me lajme të rreme, megjithëse nuk ka një model të veçantë të konsumit të medias mes atyre që besojnë në teoritë konspirative.

të dallueshëm gjeopolitik. Nga njëra anë, ka çështje që lidhen pashmangshmërisht me Kinën. Nga ana tjetër, ka hamendësime në lidhje me përfshirjen e ShBA-ve ose të aktorëve të lidhur me ShBA-të: teoria e armës biologjike ushtarake amerikane dhe teoria e Bill Gates. Ndonëse grupi i fundit i besimeve është disi më pak i përhapur (dhe jo për t'u habitur, duke pasur parasysh që origjina kineze e virusit është përgjithësisht e pakontestueshme), ky grup teorish është ende i pranishëm.

Sondazhi nxjerr në pah një ndarje gjeopolitike të llojeve, ku serbët duket se kanë një mendim më pozitiv për Kinën në krahasim me qytetarët e kombësive të tjera. Të anketuarit nga Serbia ishin ata me besimin më të ulët se virusi u krijua nga Kina (35%) dhe se ai doli nga një laborator në Wuhan (39%). Këto shifra janë më të larta në vendet e tjera, veçanërisht në Shqipëri, ku ato qëndrojnë në nivelin 65% dhe 58%, përkatësisht. Ndonëse në Serbi shifrat janë relativisht të ulëta tek të anketuarit, ato gjithsesi na ndihmojnë të eidentojmë se hendeku mes besimit në teoritë konspirative me origjinë nga ShBA dhe Kina është jashtëzakonisht i vogël, ndërkohë që në vendet e tjera ky hendek është



Grafiku 3: Mbështetja për teoritë konspirative sipas shtetit

Gjeopolitika dhe teoritë konspirative

Nëse arsimi, mosha dhe gjinia nuk janë parashikues të mirë të besimit në teoritë konspirative në Ballkanin Perëndimor dhe as ndarja urbane-rurale, a mund të gjejmë një përgjigje të gjeopolitika? Në fund të fundit, teoritë kryesore konspirative që lidhen me Covid-19 dhe të testuara në sondazhin tonë kanë një komponent

shumë më i madh, ku teoritë e origjinës së virusit nga ShBA tërheqin më pak mbështetës.

Është me interes të eidentohet se qytetarët etnikë serbë në Mali të Zi dhe Kosovë shprehin një besim më të ulët në teoritë konspirative për origjinën e virusit nga Kina në krahasim me grupet e tjera etnike. Duke pasur parasysh daljen publike të Presidentit serb Aleksandër Vuçiç për të shprehur mirënjohjen ndaj Kinës gjatë

9 Në SHBA, parashikuesi më i madh për besimin në konspiracione është arsimi. Sa më pak të arsimuar, aq më e madhe është përqindja e besimeve në teori konspirative, ndërsa ata më të arsimuarit kanë nivel shumë të ulët të besimit në teori konspirative dhe nivel të lartë refuzimi të tyre (78% përkundër 15%, d.m.th. pak "të pavendosur"). Katherine Schaeffer, "A look at the Americans who believe there is some truth to the conspiracy theory that COVID-19 was planned," (Një vështrim tek amerikanët që besojnë se ka disa të vërteta të teorisë konspirative se Covid-19 ishte i planifikuar), Pew Research Center, 24.7.2020, <https://www.pewresearch.org/fact-tank/2020/07/24/a-look-at-the-americans-who-believe-there-is-some-truth-to-the-conspiracy-theory-that-covid-19-was-planned/some-truth-to-the-conspiracy-theory-that-covid-19-was-planned/>

krizës së koronavirusit, duke i cilësuar vazhdimisht kinezët si “vëllezërit” dhe “shpëtimtarët” e Serbisë, nuk është për t’u habitur se të anketuarit serbë do të prireshin më shumë për të pasur një imazh pozitiv për Kinën në krahasim me grupet e tjera. Si për krahasim, kroatët etnikë në Bosnje-Hercegovinë duket se janë qartësisht më të dhënë pas ShBA-ve sesa Kinës, ndofta si vazhdim i reagimit të tyre për mbështetjen dhe ndërhyrjen e ShBA-ve në luftë. Do të ishte mirë të theksonim këtu se numri i vëzhgimeve nga sondazhi IPSOS/BIEPAG me individë që i përkasin grupeve etnike të pakicave në secilin vend është relativisht i vogël. Prandaj, përfundimet nuk janë aq të qëndrueshme statistikisht sesa ato që u referohen të anketuarve të një vendi në tërësi. Gjithsesi, këto të dhëna mund të trajtohen si tregues dhe duhen shqyrtuar dhe analizuar me kujdes në të ardhmen.

Këto gjetje paraprake tregojnë edhe një ndryshim mes besimeve që kanë grupet etnike të shumicës dhe pakicës në disa vende. Rasti i sipërpërmendur i serbëve të Kosovës që kanë mendim më të favorshme sesa bashkatdhetarët e tyre shqiptarë për teoritë që lidhen me Kinën është veçanërisht mahnitës kur krahasohet me besimin te teoritë e tjera konspirative, besim që është jashtëzakonisht i madh. Rreth 86.1% e serbëve të Kosovës të anketuar në këtë sondazh besojnë në teorinë e konspiracionit të Bill Gates dhe një përqindje tronditëse prej 93.7% e njerëzve të anketuar në këtë grup mendojnë se industria farmaceutike ka luajtur një rol aktiv në krijimin dhe përhapjen e koronavirusit. Po ashtu, grupet etnike jo-shumicë në Mal të Zi (serbë, shqiptarë dhe myslimanë/boshnjakë) dhe në Maqedoninë e Veriut (shqiptarë) janë dukshëm më të prirur të besojnë në teoritë konspirative sesa grupet etnike që janë shumicë në këto vende. Këto rezultate duket se sugjerojnë që disa grupe pakice, që mund të ndjehen të pambrojtur nga qeveria në të drejtat e tyre, janë më mosbesues ndaj autoriteteve, dhe për këtë arsye priren më shumë të mendojnë se ndaj tyre po bën komplete. Prandaj, ndonëse gjeopolitika mund të luajë një rol, dinamika e brendshme e ndërtimit të besimit mes autoriteteve dhe qytetarëve mund të jetë një prizëm më i mirë nëpërmjet të cilit mund të shpjegohen qëndrimet e grupeve shoqërore dhe etnike ndaj teorive konspirative në rajon. Së fundi, besimi në teoritë konspirative është qartësisht më i pranishëm tek euroskeptikët se tek ata që janë në favor të integritimit në BE: 60.6% e kundërshtarëve

të anëtarësimit në BE besojnë më shumë në një teori konspirative në krahasim me 48.9% të eurofilëve – ku diferenca është pothuajse 12%.

Ndikimi i teorive konspirative

Besimi në teoritë konspirative nuk është një bindje e çuditshme e disa të huajve: në kontekstin e pandemisë Covid-19, pasojat në shëndetin publik janë të mëdha. Studime të shumta tregojnë se ata që besojnë në teoritë konspirative kanë më pak të ngjarë të bëjnë vaksinën, kur kjo e fundit të ketë dalë¹⁰. Kur vaksina të jetë gati, është e qartë se përveç shpërndarjes së saj, për kapërcimin e pandemisë është me rëndësi të madhe edhe gatishmëria e qytetarëve për t’u vaksinuar. Vaksinimi i popullsisë është i nevojshëm jo thjesht për të mbrojtur qytetarë më të rrezikuar, por edhe për të mundësuar një rikthim të plotë në jetën normale shoqërore dhe ekonomike. Megjithatë, qytetarët evropianë janë të lodhur, pavarësisht se janë të paduruar për t’u kthyer në ‘normalitet’. Shqetësimi më serioz i shumë qytetarëve që nuk janë të gatshëm të marrin vaksinën lidhen me çështje të sigurisë për shkak të shpejtësisë së zhvillimit të vaksinës. Në përgjithësi, raporti në pjesën më të madhe të vendeve në Evropë tregon një shumicë të vogël që janë në favor të marrjes së vaksinës.

Në periudhën kur u krye ky sondazh (tetor 2020) gatishmëria e qytetarëve në Ballkanin Perëndimor për të marrë vaksinën është më e ulët se në vendet e tjera të Evropës. Në të gjithë rajonin, 53.4% nuk do ta merrnin vaksinën (me përgjigje ‘sigurisht që jo’ ose ‘ndofta jo’), ndërkohë që vetëm 39.2% do ta merrnin vaksinën (duke u përgjigjur ‘sigurisht që po’ ose ‘ndofta po’). Të dhëna të krahasueshme nga e njëjta periudhë nxjerrin në pah se gatishmëria në Gjermani është 53%¹¹, në Austri 45%¹², dhe në Francë 54%¹³. Të ndarë sipas vendeve, në Ballkanin Perëndimor, shifrat më të larta janë në Malin e Zi, kur vetëm 44.8% iu përgjigjën “sigurisht që po” ose “ndofta po” pyetjes për marrjen e vaksinës. Në vendet e tjera, shumica e refuzon vaksinimin, kur më shumë se një e treta i përkasin grupit “sigurisht që jo”. Ashtu si gjetkë, ka një bashkëlidhje të fortë mes besimit në teori konspirative dhe refuzimit të vaksinës.


10 Studimet në Francë tregojnë një bashkëlidhje të madhe mes besimit në teori konspirative dhe refuzimit të vaksinës. Paul Bertin, Kenzo Nera, Sylvain Delouvé, “Conspiracy Beliefs, Rejection of Vaccination, and Support for hydroxychloroquine: A Conceptual Replication-Extension in the COVID-19 Pandemic Context,” (Besimet në konspiracione, refuzimi i vaksinimit, dhe mbështetje për hidroksiklorokinën: Përhapje-shtrirje konceptuale në kontekstin e pandemisë Covid-19), *Frontiers in Psychology*, doi: 10.3389/fpsyg.2020.565128, edhe në Gjermani Cornelia Betsch, “Ergebnisse aus dem COVID-19 Snapshot Monitoring COSMO: Die psychologische Lage,” Universität Erfurt, 20.11.2020.

11 Betsch, Ergebnisse aus dem COVID-19 Snapshot Monitoring.

12 Gallup Stimmungsbarometer Corona, 10.11.2020, <https://www.gallup.at/de/unternehmen/studien/gallup-stimmungsbarometer-home-office/>

13 IPSOS, “Global Attitudes on a COVID-19 Vaccine, Ipsos survey for The World Economic Forum, Conducted October 8-13, 2020,” <https://www.ipsos.com/en/global-attitudes-covid-19-vaccine-october-2020>





Grafikon 3: Podrška teorijama zavere po zemljama

Në të gjithë rajonin, parashikuesit më të mëdhenj janë moshë (sa më të mëdhenj në moshë dhe, rrjedhimisht, më të shqetësuar se mund të sëmuren seriozisht, aq më të prirur janë për të marrë vaksinën); arsimit dhe gjinia, ku femrat janë shumë më të rezervuar për vaksinën sesa meshkujt. Megjithatë, edhe etnia ka rëndësi. Veçanërisht te serbët e Kosovës, komuniteti më i predispozuar ndaj teorive konspirative, shfaqet edhe rezistenca më e madhe ndaj vaksinimit: 89.6% e serbëve të anketuar nga Kosova e refuzuan vaksinën.

Përfundim

Përtej shëndetit publik, teoritë konspirative minojnë besimin te shteti dhe te politikëbërja e arsyetuar dhe e bazuar në shkencë. Është e qartë se implikimet shkojnë përtej pandemisë. Së pari, forca e konspiracioneve në Ballkanin Perëndimor, shumë më të përhapura në segmente të gjera të shoqërisë sesa gjetkë në Evropë, nënvizojnë dhe përforcojnë mungesën e besimit te shoqëria dhe institucionet. Për më tepër, konspiracionet nxisin mesazhet e forta që fajësojnë shtetet fqinje apo

fuqitë e mëdha për një sërë sëmundjesh dhe shpesh etiketojnë politikanët e opozitës dhe aktivistët kritikë (apo qeveritë) si pjesë e kompleteve dashakeqëse globale. Këto konspiracione nuk rrezikojnë thjesht të dëmtojnë luftën kundër pandemisë, por edhe të cenojnë demokracinë në rajon. Niveli i lartë i besimit te teoritë konspirative përkon me rritjen e kërkesës për udhëheqje me dorë të fortë dhe rënie të demokracisë, duke krijuar terren pjellor për rënie të mëtejshme të demokracisë dhe për antagonizëm.

Nuk është e lehtë të ballafaqohesh me këtë përzierje të paqëndrueshme. Siç thekson studimi, arsimit vetë nuk i jep fund përhapjes së teorive konspirative, as moshë apo shpresa te brezi i ri. Siç theksohet edhe nga prirja e lartë ndaj teorive konspirative mes disa pakicave, është ndjenja e cenueshmërisë dhe besimi i ulët te shteti që nxisin teoritë konspirative. Po ashtu, grupimet konkurruese gjeopolitike në rajon i japin formë teorive konspirative, duke nxjerrë në pah se trajtimi i këtyre teorive dhe rreziqeve që sjellin ato kërkon më shumë sesa thjesht diskreditimin e vetë teorive apo luftën kundër lajmeve të rreme.

Metodologjia

Të dhënat parësore që përdoren në këtë analizë politikash të BiEPAG vijnë nga një sondazh i opinionit publik të kryer në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor në muajin tetor 2020. Sondazhi u krye me një kampion përfaqësues kombëtar prej 1,000 të anketuarish të moshës mbi 18 vjeç, nëpërmjet intervistave telefonike dhe online duke ndjekur këtë raport: Shqipëria (telefon + online, 90:10), Bosnje-Hercegovina (telefon + online, 80:20), Kosova (telefon, 100), Mali i Zi (telefon + online, 90:10), Maqedonia e Veriut (telefon + online, 90:10) dhe Serbia (telefon + online, 80:20). Rezultatet jepen në përqindje dhe janë subjekt i gabimeve të mëposhtme statistikore: Shqipëria $\pm 3.39\%$, Bosnje-Hercegovina $\pm 3.39\%$, Kosova $\pm 3.32\%$, Mali i Zi $\pm 3.36\%$, Maqedonia e Veriut $\pm 3.34\%$ dhe Serbia $\pm 3.38\%$. Mbledhja e të dhënave u realizua nga Ipsos Strategic Marketing.

Fondi Evropian për Ballkanin 2020. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autor(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet dhe pikëpamjet e Fondit Evropian për Ballkanin.





<https://biepag.eu>

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotëron pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave.

Ky grup përbëhet nga hulumtues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Aktualisht, anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Vedran Džihic, Donika Emini, Dejan Jović, Marko Kmezić, Jovana Marović, Srđan Majstorović, Milan Nić, Zoran Nechev, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nicolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergi Vurmo, Jelena Vasiljević, dhe Natasha Wunsch.

www.balkanfund.org

Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha kryesore - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritit në BE.

EFB mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platformën ku qytetarë të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive, aleksandra.tomanic@balkanfund.org

www.suedosteuropa.uni-graz.at

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe edukimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinar.

Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinar juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon konferenca dhe seminare ndërkombëtare rregullisht për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore.

Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER, Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore, florian.bieber@uni-graz.at

Kontakt: UNIV.PROF. DR. FLORI JAN BIBER, profesor studija Jugoistočne Evrope, florian.bieber@uni-graz.at